

tetor-dhjetor 1998, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

Ali (Metë) Krasniqi

(25.10.1913, shqiptar nga Negroci/Negrovce, komuna e Glogocit/Glogovac, gjashtë fëmijë)

Aliu i moshëthyer dhe shtatë anëtarë të familjes së tij jetonin në *Mëhallën Krasniqi*. Kur më **25.09.1998**, forcat serbe e sulmuan fshatin **Negroc/Negrovce**, familja e Aliut u largua nga shtëpia e saj dhe u strehua në një pyll në afërsi të fshatit. Aliu, i cili ishte i palëvizshëm, ka mbetur në shtëpi. Po atë ditë, djali i Aliut Pajaziti, nga vendi ku qëndronin të fshehur në pyll, ka vërejtur se forcat serbe i kishin vënë zjarrin dhe e kishin djegur shtëpinë e tyre familjare. Një ditë më vonë, kur forcat serbe u tërhoqën, Pajaziti u kthye në Negroc/Negrovce. Në shtëpinë e djegur i ka gjetur mbetjet e trupit të Aliut. Po atë ditë [26.09.1998], Pajaziti e ka varrosur të atin në varrezat e *Mëhallës Krasniqi*. Pajaziti i kishte gjetur në muret e shtëpisë shumë vrima nga plumbat dhe, në bazë të kësaj, ai ka nxjerr përfundim se të atin së pari ia kanë mbytur, ndërkaq pastaj ia kanë vënë zjarrin shtëpisë. Pas përfundimit të luftës, më 4.09.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Aliut në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovce.

Burimi: deklarata P.K, FDH-18033.

Skënder (Hyd) Krasniqi

(5.02.1953, shqiptar nga Negroci/Negrovce, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor ndërtime, pesë fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar fshatin **Negroc/Negrovce** më **25.09.1998**. Për shkakë sigurie, familja e Skënderit vendosi që ta braktiste fshatin. U strehuan në fshatin fqinj të Vuçakut/Vučak. Por, Skënderi nuk deshë të lëvizte nga shtëpia e vet. Në mbrëmje të datës 29.09.1998, familjarët kanë dëgjuar në radio se Skënderin e kishin vrarë në Negroc/Negrovce, në të njëjtën ditë kur ata e kishin braktisur fshatin. Trupin e Skënderit e kishte gjetur fshatari Halim Krasniqi te vendi i quajtur *Shpati i*

Lazes. Familjarët e Skënderit u kthyen në fshat më 29.09.1998. Po atë ditë, e kanë varrosur atë në varrezat e *Mëhallës Krasniqi* në Negroc/Negrovce. Pas përfundimit të luftës, më 4.09.1999, mbetjet mortore të Skënderit janë rivarrosur në varrezat lokale në Negroc/Negrovce.

Burimi: deklarata G.K, FDH-18028.

Sadri (Hasan) Muqolli

(7.1.1945, shqiptar nga Pokleku i Vjetër/Novi Poklek, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor, katër fëmijë)

Naim (Qazim) Kluna

(3.02.1961, shqiptar nga Pokleku/Poklek, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Naimi ishte i punësuar në mullirin e bashkëfshatarit Sefer Smajlit. U bë anëtar i UÇK-së në vitin 1997. Sadriu punonte në Zyrën e Ofiqarit në komunën e Glogocit/Glogovac. Në datën 19.09.1998, për shkak të sulmit të forcave serbe, Sadriu me familje dhe banorë të tjerë u strehuan në pyllin mbi fshatin e tyre [**Poklek/Poklek**]. Më vonë, ai më një grup burrash të fshatit, në mesin e të cilëve ishte edhe Naim Kluna, u ndanë nga grupi i grave dhe fëmijëve. Në orët e vona të mbrëmjes së datës **25.09.1998**, pjesëtarë të forcave serbe e kanë zbuluar grupin e burrave dhe, në përlëshjen e armatosur që shpërtheu në mes të dy anëve, kanë rënë Sadriu dhe Naimi. Dy ditë më vonë, ata u varrosën në varrezat e Poklekut/Poklek.

Burimet: deklarata S.M, FDH-31843; deklarata H.K, FDH-31842; deklarata H.K, FDH-31842; KMDLNJ, *Bulletini*, num. 9, tetor – dhjetor 1998, 117, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Fadil (Asllan) Krasniqi

(8.06.1977, shqiptar nga Negroci/Negrovce, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor ndërtime, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Fadili ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Në oborrin e tij ka qenë e vendosur selia e shtabit lokal të UÇK-së. Fadili ishte i ngarkuar me organizimin e rojës në fshat dhe shpërndarjen e armatimeve nëpër